



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:111967
Datë: 04.03.2024
Numri i dokumentit: 05407093

AA.nr.545/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar i kolegjit, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti, anëtarë të kolegjit, në konfliktin administrativ, sipas padisë së paditësit N.K nga Prishtina, kundër të paditurës, Komisioni Qeveritar i Qeverisë së Kosovës për të Drejtat e ish të Dënuarve dhe ish të Përndjekurve Politikë në Prishtinë, me bazë juridike heshtje administrative, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative, A.nr.1270/2021 të datës 11.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 14.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Miratohet si e bazuar ankesa e paditësit N.K nga Prishtina, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative A.nr.1270/2021 i datës 11.05.2023 prishet, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1270/2021 të datës 11.05.2023 është vendosur të **KONSIDEROHET** se është tërhequr padia e paditësit N.K, me shenjen A.nr.1270/2021, e dt.07.06.2021, për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore për padi.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë paditësi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore (neni 168 par.2) si dhe neni 180 të LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që gjykatësja ka marrë aktvendim për tërheqjen e padisë në kundërshtim me nenin 374 të LPK-së, pa e shqyrtuar kërkesën e tij, që të vendoset se a i plotëson kushtet e Udhëzimit Administrativ mbi lirimin nga pagesa e taksës gjyqësore. Me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit si e drejte dhe e paraqitur brenda afatit ligjor ashtu që të ndryshohet aktvendimi i ankimuar duke e shfuqizuar si jo të drejtë dhe ligjor dhe rastin ta kthej në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë apo vendosjen e padisë në masë sigurim për veprim të shpejt bazuar në moshën e paditësit.

Përgjigje në ankesë nuk kanë paraqitur pala e paditur.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 paragrafi c) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka gjetur se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, N.K, ka parashtruar padi në gjykatë me dt. 07.06.2021, kundër të paditurës, Komisioni Qeveritar i Qeverisë së Kosovës për të Drejtat e ish të Dënuarve dhe ish të Përndjekurve Politikë, duke kërkuar të aprovet padia dhe kërkesëpadia e tij dhe të detyrohet e paditura që t'i përcaktoj beneficionet që i takojnë sipas statusit të përndjekurit politik.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e përgatitjes së shqyrtimit kryesor të çështjes, pas shqyrtimit paraprak të padisë, ka gjetur se, padia e paditësit nuk përmban dëshmi se i njëjti e ka paguar taksën gjyqësore për padi.

Me dt. 05.04.2023, gjykata e shkallës së parë ia ka dërguar paditësit vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore në shumën prej 50 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, dhe dëshminë e fletëpagesës t'ia dorëzoi gjykatës, nën kërcënimin e pasojave juridike në rast të mosveprimit sipas udhëzimeve të gjykatës.

Paditësi ka pranuar vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore me datën 28.04.2023, mirëpo taksën nuk e ka paguar, në vend të kësaj ka dorëzuar parashtrësë me dt.04.05.2023, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që ta liroj nga pagesa e taksës gjyqësore për padi, siç lirohen të burgosurit politik, konform nenit 3 dhe 4 të Ligjit 03/L-095 PËR TË DREJTAT E ISH TË DENUARVE DHE TË PËRNDJEKURVE POLITIKË se edhe përkundër rrezikimit ekzistencial (me 100 euro në muaj) ai do të shtrëngohet ta paguaj. Gjykata e shkallës së parë pas analizimit të parashtrësës së paditësit, konstatoi se paditësi nuk e ka paguar taksën gjyqësore dhe në rastin konkret nuk ekzistojnë kushtet për lirimin nga pagimi i të njëjtës, gjykata duke marrë parasysh arsyet e dhëna më lartë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 253.5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, lidhur me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Nr.01/2017, të datës 22.03.2017, për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, si dhe Mendimit Juridik të dhënë nga Gjykata Supreme e Kosovës me nr.64/2016, të datës 18.02.2016.

Kolegji i Gjykatës të Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe pas ekzaminimit të aktvendimit të ankimuar, dhe shkresave të tjera të lëndës, e duke i pasur parasysh edhe pretendimet ankimore, vëren se aktvendimi i kontestuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 nën paragrafi i) dhe 253 paragrafi 5 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, për çfarë u dashtë që ky aktvendim të priset.

Kolegji i Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrativ, duke e vlerësuar ankesën e parashtruar nga paditësi, aktvendimin e kundërshtuar si dhe shkresat e tjera nga lënda, konstatoj se në këtë rast paditësi me an të parashtrësës se veçante të datës 04.05.2023, ka kërkuar

nga gjykata që ta liroj nga pagesa e taksës gjyqësore për padi, se konsideron se i plotëson kushtet ligjore për lirim nga pagesa.

Për rastin konkret me vështrim në shkresat e lëndës konstatohet se paditësi, ka paraqitur parashtresë të veçante me kërkesë për lirim nga taksa gjyqësore, mirëpo gjykata nuk ka vendosur lidhur me kërkesën për lirim nga taksa gjyqësore, por pa të drejtë ka marrë aktvendim dhe padinë e ka konsideruar si të tërhequr për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore.

Sipas dispozitës së nenit 468 paragrafi 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore gjykata mund ta liroj palën vetëm nga taksat gjyqësore po që se me pagimin e tyre do të pakësoheshin dukshëm mjetet për ushqimin e tij dhe të familjes së ngushtë të tij.

Duke marrë parasysh faktin e ekzistimit të parashtresës së veçante të datës 04.05.2023 me kërkesë për lirim nga taksat gjyqësore, siç lirohen të burgosurit politik, dhe gjendjes së rende ekonomike, nga e cila varet edhe fati i kërkesës së tij në këtë çështje juridike. Gjykata e shkallës së parë, është dashur të vendos lidhur me kërkesën-propozimin për lirim nga taksa gjyqësore duke i thënë Këshillën Juridike se kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e jo të vendos për padinë duke e konsideruar të tërhequr për shkak të mos pagesës së taksës për padi.

Meqenëse gjykata e shkallës së parë ka lëshuar të vendos lidhur me kërkesën-propozimin e paditësit për lirim nga taksa gjyqësore në këtë kontest, nuk ka pasur vend për marrjen e aktvendimit të atakuar, ngase është bërë shkelje esenciale e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika i) lidhur me nenin 468 paragrafi 3 dhe 4 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së. Meqë paditësi ka të drejtë të ushtrimit të ankesës në Gjykatën e Apelit në Prishtinë kundër aktvendimit për refuzimin e kërkesës për lirim nga taksa gjyqësore.

Pas vlerësimit të kësaj çështje juridiko-administrative është dashtë që të miratohet ankesa e paditësit dhe aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të priset, dhe lënda ti kthehet gjykatës se njëjte në rishqyrtim dhe rivendosje.

Në vazhdim të procedurës gjykata e shkallës së parë do të vlerësoi bazëueshmerin e kërkesës - propozimit të paditësit të paraqitur me parashtresë të veçante të datës 04.05.2023 në kuptim të dispozitave të nenit 468 të LPK-së dhe me tutje të veproi sipas ligjit.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, i cili zbatohet në kuptim të nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.361/2017, datë 14.02.2024

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi